

MODELI PËR DOKUMENTIN KONSULTATIV

Për draft projektligjin e Kujdesit alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë:

(Përcaktoni/shkruani komentet e kujt po kërkon (veçanërisht), p.sh. komente (të përgjithshme) publike, nga komuniteti ekspert në fushën përkatëse, nga organet përfaqësuese të komunitetit të biznesit, nga organizatat joqeveritare dhe individët me përvojë në fushën përkatëse, etj.)

Komentet e kërkuara do të jenë nga:

- Institucionet shtetërore si: Shërbimi Social Shtetëror, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit;
- Institucionet përgjegjëse dhe individët me përvojë në fushën përkatëse si: Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve në disa bashki të vendit, personat përgjegjës në drejtoritë e shërbimeve sociale në bashkitë e vendit;
- Organizata të Shoqërisë Civile si: UNICEF, Save the Children, Fshatrat SOS, Bethany Social Services, Nisma për Ndryshim Shoqëror, ARSIS, Terre des Homes, CRCA, Shoqata “Ndihmoni Jetën”, ALO 116, World Vision;
- Urdhrat e ndryshëm si: Urdhri i Psikologut dhe Urdhri i Punonjësit Social.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Shtator-Tetor 2025

Si të përgjigjeni:

Shkruani si mund të përgjigjen palët e interesuara/publiku në konsultime, p.sh. Me email:, Me postë në:, Duke plotësuar formularin në internet në RENJKP (siguroni linket e drejtpërdrejta).

Konsultimet për draft projektligjin e kujdesit alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë do të zhvillohen online ose pranë ambienteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Komentet do të dërgohen në adresat e emaileve të anëtarëve të grupit të punës për hartimin e këtij projektligji.

Kontakti:

Duhet të jepen të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe /ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet.

Konsultimet për draft projektligjin e kujdesit alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë, fillimisht do të dërgohen pranë sekretarisë së Zëvendësministres së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe me tej do të organizohen anëtarët e grupit të punës për të analizuar dhe përmbledhur të gjitha komentet e dhëna.

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Siguroni informacionin nëse ato janë të organizuar.

Më datë 16.09.2025 do të organizohet takimi online në Platformën Microsoft Teams me pjesëmarrës të PMF-ve në disa bashki të vendit dhe me Angjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;

Më datë 18.09.2025 do të organizohet takimi në ambientet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me pjesëmarrës të drejtorëve të shërbimeve sociale në bashkitë e vendit;

Më datë 19.09.2025 do të organizohet takimi në ambientet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile;

Në fillim të muajit tetor do të hidhet në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për konsultim publik Projektligji për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë, RIA, Projektvendimi dhe relacioni shpjegues. Ky konsultim publik do të mbyllet më datë 31.10.2025.

Sfondi i propozimit legjislativ

Përshkruani pse ka nevojë për rregulloren e re/të ndryshuar, d.m.th cila është gjendja aktuale, si është e rregulluar, cilat janë sfidat, problemet dhe mangësitë ekzistuese si të praktikës, ashtu edhe të rregulloreve ekzistuese, çfarë është bërë në të kaluarën ashtu siç duhet me keto politika.

Projektligji për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë është hartuar në mungesë të një kuadri të posaçëm ligjor, për fëmijët pa kujdes prindëror ose në rrezik për ta humbur atë, për të siguruar të drejtën që çdo fëmijë të rritet në një mjedis familjar të sigurt, duke reduktuar varësinë në institucionet e perkujdesit shoqëror rezidencial. Ky ligj është i domosdoshëm për të garantuar zhvillimin e një sistemi funksional dhe afatgjatë të kujdesit alternativ familjar, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me objektivat kombëtare për forcimin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, pasi kujdestaria familjare deri më tani njihet dhe zbatohet në një formë të kufizuar.

Propozimet

Renditni dhe përshkruani në mënyrë të shkurtër dhe koncize të gjitha propozimet dhe ndryshimet që doni të prezantoni me rregulloren e reja. Përdorni një gjuhë të thjeshtë.

Propozimi në këtë draft projektligj të kujdesit alternative në familje në Republikën e Shqipërisë do të përmbajë detyrimet që burojnë nga Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (nenet 20–21) dhe Udhëzimi i OKB-së për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve, të cilat theksojnë të drejtën që çdo fëmijë të rritet në një mjedis familjar të sigurt.

Gjithashtu, në kuadër të kapitullit 23 dhe 19, raportet e dhëna nga Bashkimi Europian kanë nënvizuar rëndësinë e forcimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri si pjesë e procesit integrues.

Draft projektligji do të sigurojë mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës në një mjedis familjar të sigurt, duke reduktuar dhe minimalizuar institucionalizmin e fëmijëve në qendrat rezidenciale. Në këtë mënyrë do të ndërmerren hapa për të realizuar Planin Kombëtar të Transformimit të Përkujdesit Shoqëror Rezidencial për Fëmijët drejt shërbimeve alternative për fëmijën dhe familjen 2025-2026. Në shërbimet alternative për fëmijën dhe familjen do të sigurohet forcimi i mbështetjes prindërore dhe parandalimi i ndarjes nga familja biologjike.

Pyetjet

Listoni pyetje për të cilat po kërkon reagime. Ato mund të lidhen me propozimet tuaja (p.sh. A jeni dakord me propozimin për ..., A jeni dakord që duhet të ndërmerren veprime të mëtejshme për të

parandaluar/rritur ..., A jeni dakord që ne e quajmë shkelje ..., A pajtoheni me përkufizimin tonë të ri për ..., etj.) ose thjesht përdoren për të mbledhur të dhëna shtesë që ju kërkoni (p.sh. Cili do të ishte ndikimi i propozimeve tona në biznesin tuaj, organizatat, A e bën organizata juaj ..., etj.). Ju mund të merrni parasysh kufizimin e gjatësisë së përgjigjeve për pyetjet individuale (p.sh. 250/500 fjalë).

Pyetje të cilat janë me rëndësi të madhe për të hartuar ligjin e kujdesit alternativ janë të listuara si më poshtë vijon:

- *Shërbimi i kujdesit alternativ do të fokusohet vetëm në familje si rrethi më i ngushtë apo do të kemi një përfuqizim më të gjerë dhe gjithëpërfshirës?*
- *Si do të bëhet ndërthurja me ligjin nr 18/2027 për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodin e Familjes?*
- *Cilat do të jenë llojet e kujdesit alternativ?*
- *Cilat do të jenë strukturat përgjegjëse që do të bëjnë identifikimin e familjeve kujdestare, vlerësimin e situatës së fëmijës në kujdes alternativ dhe si do të monitorohet ky shërbim?*
- *A do të ngrihen struktura të reja në bashki për të bërë të mundur funksionimin e shërbimit të kujdesit alternativ?*
- *Cili do të jetë roli i Organizatave të Shoqërië Civile që mbulojnë fushën e fëmijëve në shërbimin e ofruar të kujdesit alternativ dhe si do të bashkëveprojnë institucionet shtetërore me këto organizata?*
- *Çfarë kriteresh do të përfshihen në përzgjedhjen e familjeve kujdestare?*
- *Si do të bëhen procedurat e referimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për kujdes alternativ në familje?*
- *A do të përfshihet në projektligj numri maksimal i fëmijëve që një familje kujdestare mund të ofrojë përkujdes dhe cila do të jetë kohëzgjatja e këtij shërbimi të ofruar?*
- *A do të përfshihet në këtë projektligj çështje të birësimit, ku familjet kujdestare mund të kenë të drejtën për të birësuar fëmijën që kanë në kujdestari të përkohshme?*
- *Çfarë procedurash do të ndihen në sistemin gjyqësor për të siguruar interesin më të lartë të fëmijës dhe cila do të jetë kohëzgjatja e marrjes së vendimit për të vendosur fëmijën në kujdes alternativ?*
- *Si do të jetë mbështetja financiare për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje dhe familjen kujdestare?*